



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**Këshilli Drejtues**

**V E N D I M**

**Nr. 28, datë 01.08.2019**

**PËR**

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHz, SPEKTËR I PAALOKUAR”, DHE NJOFTIMIN PËR TENDER PUBLIK, REF. 1X10 MHz I ÇIFTUAR-800-2019”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir Zela	Kryetar
2. Znj. Ketrin Topçiu	Anëtar
3. Znj. Edlira Dvorani	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 01/08/2019, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues, si dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz, spektër i paalokuar”, dhe Njoftimin për tender publik, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019.***

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 69 e vijues i Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji Nr.9918/2008**);
2. Ligji Nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**Ligji nr.44/2015**);

3. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar (**VKM nr.1252**);
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277 datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”;
5. Dokumenti - Shkresa Nr.7016/1 Prot. datë 01.08.2019 (Prot. i AKEP: 688/80, datë 1.08.2019) e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë: “Përgjigje tuajës Nr. 688/79 Prot. datë 25.07.2019, “Parashtrohet propozimi i AKEP, për vijimin e procedurës të zhvillimit të tenderit public për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz spektër i paalokuar””;
6. Urdhëri Nr.287 datë 01.08.2019, “Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 800 MHz, spektri i paalokuar, dhe ngritjen e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit;
7. Rregullore e brendshme e funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të KD të AKEP.

### **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- i. Shkresa Nr.7016/1 Prot. datë 01.08.2019 (Prot. i AKEP 688/80, datë 1.08.2019) e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë: “Përgjigje tuajës Nr. 688/79 Prot. datë 25.07.2019, “Parashtrohet propozimi i AKEP, për vijimin e procedurës të zhvillimit të tenderit public për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz spektër i paalokuar””;
- ii. Dokumentat e hartuar nga Njësia e Hartimit të dokumentave së bashku me relacionin përkatës;
- iii. Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- iv. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **VËREN se:**

- I. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr. 7016/1 Prot. datë 01.08.2019 ka miratuar kufizimet dhe procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz, spektër i paalokuar, si më poshtë:
  1. AKEP të vijojë procedurën e konkurrimit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz, spektër i paalokuar sipas ndarjes së propozuar:
    - Spektri i disponueshëm i paalokuar 2x20 MHz;
    - Madhësia e bllokut 1 x 10 MHz i çiftuar për secilin bllok A1 dhe A3;

- Blloku A1, në brezin 800 MHz, (1x10 MHz i çiftuar) për frekuencat 791-801 MHz (10 MHz) i çiftuar me 832-842 MHz (10 MHz);
  - Blloku A3, në brezin 800 MHz, 1x10 MHz i çiftuar, për frekuencat 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz);
- Brezi mbrojtjes (guard band) prej 1 MHz me fillim 790 MHz;
  - FDD downlink fillon në 790 MHz dhe FDD uplink fillon në 832 MHz.
  - Numri maksimal i Autorizimeve Individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 790-862 MHz është 2 (dy);
  - Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit Individual të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet. Koha e fillimit të shfrytëzimit të frekuencave të jetë jo më vonë se dy muaj nga data e pajisjes me Autorizim Individual;
  - Për kushtet teknike për Autorizimin Individual të aplikohen përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave;
2. Vlera minimale e pranueshme për ofertuesit për dhënien e një autorizimi individual për përdorimin e frekuencave në brezin 800 MHz për bllokun 10 MHz i çiftuar, të jetë jo më pak se **7.44 milion Euro**.
  3. Kriter i vlerësimit të ofertave të vlefshme, të jetë çmimi i ofertës sipas formulës së mëposhtme:  

$$Pox = 100 \times \frac{Çox}{Çomax}$$

Ku: *Pox* - [Pikët e një oferte të dhënë (x) në varësi të çmimit të ofertës]  
*Çox* - [Çmimi i ofertës së dhënë]  
*Çomax* - [Çmimi maksimal i ofertave]
  4. Mënyra e pagesës: Pagesë e plotë në momentin e dhënies së autorizimit individual.
  5. Dokumentacioni “Për miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), spektër i paalokuar”, dhe Njoftimin për tender publik, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli Drejtues i AKEP, në referim me dispozitat ligjore që rregullojnë zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik për të dhënë autorizime individuale për një numër të kufizuar të drejtash për përdorimin e frekuencave, si dhe duke marrë në konsideratë:

- i. Dokumentin e Tenderit;
- ii. Njoftimin për Tender Publik;

- iii. Shkresa Nr.7016/1 Prot. datë 01.08.2019 (Prot. i AKEP 688/80, datë 1.08.2019) e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë: *“Përgjigje tuajës Nr. 688/79 Prot. datë 25.07.2019, “Parashtrohet propozimi i AKEP, për vijimin e procedurës të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz spektër i paalokuar””*;
- iv. Urdhëri Nr. 287 datë 01.08.2019, *“Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 800 MHz, spektri i paalokuar, dhe ngritjen e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit*

### **VENDOS:**

1. Të miratojë Dokumentin e Tenderit publik me *“Procedurë të Hapur”* me objekt: *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), spektër i paalokuar, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019”*, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë Njoftimin për Tender Publik, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Njoftimi për Tender të botohet në dy Gazeta Kombëtare dhe në një Gazetë Ndërkombëtare.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**Illir ZELA**

**Ketrin TOPÇIU**

**Edlira DVORANI**

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**NJOFTIM**

**PËR ZHVILLIMIN E TENDERIT PUBLIK ME OBJEKT:**

**DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT  
NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHz (792-862 MHz), SPEKTRI I PAALOKUAR**

**Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019**

- 1. Autoriteti pergjegjes:** Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)  
Rruga “Reshit Çollaku”,  
Tiranë – Shqipëri  
Tel/Fax: 04 259571/04 259106,  
E-mail: [info@akep.al](mailto:info@akep.al); Adresa web: [www.akep.al](http://www.akep.al);
- 2. Lloji i procedurës së tenderit:** “Procedurë e Hapur”
- 3. Objekti i tenderit:** *“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), spektrër i paalokuar, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019”*
- 4. Çmimi:**
  - a) Vlera minimale e pranueshme për ofertuesit për dhënien e një autorizimi individual për përdorimin e frekuencave në brezin 800 MHz për bllokun 10 MHz i çiftuar, të jetë jo më pak se **7,440,000 (shtatë milion e katërqind e dyzet mijë) Euro.**
  - b) Ofertuesit të cilët ofrojnë në ofertën e tyre një çmim më të vogël se kjo vlerë, do të skualifikohen.

**5. Afati dhe adresa për dorëzimin e ofertave:**

Ofertat duhet të dorëzohen jo më vonë se data **09.09.2019, ora 10:00**, në adresën:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)  
Rruga “Reshit Çollaku”,  
Tiranë - Shqipëri

**6. Data e hapjes së ofertave: 09.09.2019, ora 10:00**

Në ambjentet e AKEP në adresën :  
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)  
Rruga “Reshit Çollaku”,  
Tiranë - Shqipëri

**7. Gjuha e ofertës :** Gjuha e ofertës do të jetë gjuha shqipe ose angleze.

**8. Dokumentat e tenderit** në formë të printuar mund të tërhiqen në ambjentet e AKEP, gjatë cdo ditë pune duke filluar nga data 06.08.2019, nga ora 9:00 deri në orën 15:30. Personi që do të paraqitet për tërheqjen e dokumentit të tenderit duhet të ketë me vete dokumentin e bankës që vërteton kryerjen e pagesës prej 10 (dhjetë) Euro, e cila kryhet në një nga llogaritë bankare të AKEP, sipas sqarimeve në Dokumentin e Tenderit.

Dokumenti i Tenderit mund të shkarkohet *pa pagesë* nga faqja elektronike e AKEP, në adresën [www.akep.al](http://www.akep.al).